

Termet e referencës

Pozita	Trajner për ngritje të kapaciteteve për OSHC-të që punojnë me të rinjtë
Forma e kontraktimit	Kontratë shërbimi
Kohëzgjatja	Deri në 15 ditë
Afati i fundit për aplikim	20 shkurt, 2019
Numri i pozitave	1

Informata të përgjithshme

Organizata LENS është në vitin e dytë të zbatimit të projektit Web4yes (Organizatat e Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor për Punësimin e të Rinjve), i cili tenton t'u përgjigjet drejtpërdrejtë nevojave socio-ekonomike të qytetarëve të rinj, të adresuara përmes shërbimeve cilësore për të rinjtë e papunë.

Web4yes është një projekt rajonal i cili implementohet nga 7 organizata të shoqërisë civile nga Ballkani Perëndimor. Pjesë e këtij bashkëpunimi janë: organizata BOS nga Serbia, organizata LENS nga Kosova, Instituti për Zhvillimin e të Rinjve KULT nga Bosnja dhe Hercegovina, Shoqata për Prosperitet Demokratik ZID nga Mali i Zi, Shoqata Përtej Barrierave nga Shqipëria, Këshilli Kombëtar i Rinisë nga Maqedonia, dhe Olof Palme International Center nga Suedia.

Ky projekt përfaqëson një iniciativë rajonale të dizajnuar për të ofruar qasje inovative ndërkulturore dhe për t'ua krijuar të rinjve të papunë të rajonit të Ballkanit Perëndimor mundësinë për të rritur aftësitë e tyre të punësimit dhe për tu punësuar. Projekti është hartuar për të adresuar sfidat ekzistuese të bashkëpunimit joadekuat ndërmjet pjesëtareve të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike në Ballkanin Perëndimor në proceset e politikave dhe vendimmarrjen drejt reformave që lidhen me papunësinë e të rinjve.

Pra, projekti synon të fuqizojë pozitën e shoqërisë civile për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në adresimin e shumë çështjeve të punësimit dhe sipërmarrjes nëpërmjet aktiviteteve të tyre të avokimit dhe mbikëqyrjes në nivelin kombëtar dhe rajonal dhe duke i kushtuar më shumë vëmendje nevojave të të rinjve në politikat vendimmarrëse.

Gjatë këtyre viteve të zbatimit, projekti Web4yes do të fokusohet në veprimet e mëposhtme:

- Dialogu i politikave që kanë në interes punësimin e të rinjve
- Avokimi dhe monitorimi i politikave për përmirësimin e punësimit dhe sipërmarrjes së të rinjve
- Ndërtimi i kapaciteteve për OShC-të e dedikuara për të rinjtë Ballkanin Perëndimor
- Mbështetje me Sub-Grante për iniciativat e OShC-ve lokale
- Zhvillimi i platformës elektronike në shërbim të të rinjve nga Ballkani Perëndimor

Më shumë informata për projektin në fjalë mund të gjeni në: <http://web4yes.eu/>

Objektivat

Lidhur me ngritjen e kapaciteteve të OShC-ve që merren me të rinjtë, Lens po kërkon një kompani apo individ për të kryer një aktivitet trajnimi 2 ditor, për të paktën 15 pjesëmarrës që përfaqësojnë të paktën 15 organizata të ndryshme të shoqërisë civile.

Trajnimi themelor “Zhvillimi dhe Avokimi i Politikave në fushën e Punësimit të të Rinjve” do të organizohet për OShC-të e vogla që janë të dedikuara për të punuar me të rinjtë dhe veçanërisht për problemin e papunësisë së të rinjve.

Trajnimi ndahet në dy komponentë kryesore:

- a) *Planifikimi strategjik i politikave të punësimit dhe të sipërmarrjes së të rinjve në nivel nacional dhe lokal në përputhje me standardet e BE-së; Pas një pasqyre të shkurtër të politikave nacionale në lidhje me punësimin dhe sipërmarrjen e të rinjve, trajnimi do të përqendrohet në ngritjen e kapaciteteve të pjesëmarrësve për të kuptuar strategjitë kombëtare dhe përfshirjen sa më adekuate në këto procese.*
- b) *Zhvillimi i strategjive efektive dhe mjeteve të komunikimit për avokimin e politikave; komponenti i dytë i trajnimit do të përfshijë avancimin e aftësive të pjesëmarrësve në fushën specifike të avokimit të bazuar në dëshmi të sakta. Kjo pjesë e trajnimit paraqet praktikën më të mira të procesit të avokimit.*

Pritjet tona nga trajnimet

Lidhur me planifikimin strategjik të punësimit të të rinjve dhe politikave të sipërmarrjes në nivel nacional dhe lokal në përputhje me standardet e BE-së, pjesëmarrësit do të:

- njihen me kornizën e politikave për punësimin, punësueshmërinë dhe sipërmarrjen e të rinjve
- jenë të gatshëm dhe të motivuar për të përdorur njohuritë e fituara në punën e mëtejshme të organizatës që ata përfaqësojnë
- jenë në gjendje të njohin mundësitë dhe hapësirën ku organizatat e shoqërisë civile mund të përfshihen në procesin e zhvillimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave të punësimit të të rinjve
- njihen me dokumentet e shkurtra të politikave, rekomandimet në nivel rajonal
- jenë në gjendje të njohin rekomandimin që është më i rëndësishëm për mjedisin lokal në të cilin operojnë.

Lidhur me zhvillimin e strategjive më efektive të Avokimit të Politikave, pjesëmarrësit do të:

- jenë në gjendje të përcaktojnë avokimin e politikave dhe të dallojnë atë nga koncepte të tjera të ngjashme
- jenë të aftë të krijojnë procesin e avokimit në kontekstin e procesit të zhvillimit të politikave
- jenë në gjendje të kuptojnë tiparet kryesore të rrjeteve të politikave dhe karakteristikat kryesore të cikleve të politik-bërjes
- jenë në gjendje të kuptojnë se cilat janë segmentet më të rëndësishme të fushatës së avokimit, të ndihen të sigurt në zbatimin e tyre në praktikë

- jenë në gjendje të kuptojnë lidhjen ndërmjet fokusit strategjik dhe planit të avokimit dhe të jenë në gjendje bëjnë ekzaminimin e rezultateve, të gjitha me qëllim përcaktimin e objektivave realiste të avokimit dhe konceptimin e planit të avokimit i cili është i përshtatshëm për burimet ekzistuese të parashikuara për zbatimin e tij.

Kriteret për aplikim

Kandidatët e interesuar për këtë shërbim duhet të kenë:

- Së paku 5 vjet përvojë në punë që kanë të bëjnë me punësimin e të rinjve, ndërhyrjet në politik-bërje dhe avokim;
- Përvojë të dëshmuar në hartimin dhe shpërndarjen e programeve të trajnimit duke përdorur metodologji interaktive
- Aftësi të shkëlqyera në të folur dhe të shkruar të gjuhës shqipe, gjuha angleze është një avantazh;
- Shkathtësi të lartë në përdorimin e mjeteve digjitale të komunikimit;
- Përvojë gjithëpërfshirëse në ofrimin e konsulencës;
- Nivel të lartë të organizimit dhe menaxhimit të kohës.

Përgjegjësitë

Në lidhje me specifikat e mësipërme, trajneri i kontraktuar duhet të:

- Propozojë dhe përshtatë skemën e përgjithshme të programit të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të OShC-ve më të vogla, në përputhje me udhëzimet e organizatës kontraktuese dhe nevojat specifike të të trajnuarve;
- Mbajë trajnim dy ditorë me temat e lartpërmendura (deri në 8 sesione);
- Përgatitë një raport të vlerësimit lidhur me trajnimin

Periudha e kontratës

Shërbimi është planifikuar për periudhën nga 1 deri më 31 mars 2019, me një total prej 2 ditëve të trajnimit. Evidenca e kryerjes së trajnimit do të jetë lista e pjesëmarrjes dhe vlerësimet nga pjesëmarrësit.